# PYETËSORI I SHKOLLËS
# PËR PISA 2015

# VERSIONI I TESTIMIT ME SHKRIM

# VERSIONI I FAZËS FINALE

*Pyetësori i Shkollës_Faza Finale_PISA2015*

Core 6
Tetor 2014

I nderuar drejtor,

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë studim. Ky pyetësor ka për qëllim të marrë informacion me:

- Informacionet themelore rreth shkollës
- Drejtimin e shkollës
- Kuadrin mësimdhënës
- Vlerësimin
- Grupet e marra në studim
- Klimën shkollore

Ky informacion do të ndihmojë për ilustrimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve ndërmjet grupeve të shkollave me qëllimin për të përcaktuar më mirë kontekstin për rezultatet e testimit të nxënësve. Për shembull, informacioni i marrë mund të ndihmojë për të përcaktuar se çfarë efekti ka disponueshmëria e burimeve mbi arritjet e nxënësve – edhe brenda vendit edhe ndërmjet vendeve.

Pyetësori duhet të plotësohet nga drejtori i shkollës ose i deleguari i tij. Duhen rreth 60 minuta për ta plotësuar.

**Për disa pyetje mund të nevojitet ekspertizë e veçantë. Ju mund të konsultoheni me ekspertë për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve.**

Nëse nuk e dini përgjigjen me saktësi, përgjigjja juaj e përafërt do të jetë e mjaftueshme për qëllimet e studimit.

**Përgjigjet tuaja do të mbahen të fshehta. Ato do të kombinohen me përgjigjet e drejtorëve të tjerë për të llogaritur totalin dhe mesataren në të cilën nuk do të mund të identifikohet asnjë shkollë.**

Gjatë dhënies së përgjigjeve, ju lutemi t'i keni parasysh këto përkufizime:

> Lëndët e shkencave përfshin të gjitha lëndët e shkencave në shkollë që nga domeni i fizikës, kimisë, shkenca mbi planetin Tokë dhe gjithësinë, biologjisë, shkencat e aplikuara dhe teknologjia (p.sh. informatikë), të cilat mësohen në kuadër të planprogramit tuaj mësimor si lëndë të veçanta ose si lëndë e përbashkët në të cilën janë integruar shkencat natyrore. Në këtë grup NUK përfshihen lëndët si matematikë, psikologji dhe ekonomi, e as temat nga shkenca mbi planetin Tokë të cilat përfshihen në lëndën gjeografi.

**Vëni re: Në pyetjet ku kërkohen të dhënat e nxënësve të klasave të nënta dhe të dhjeta ju i plotësoni vetëm të dhënat për nxënësit që i keni në shkollën tuaj.**

## STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I SHKOLLËS

**SC001** SC001Q01TA

**Cila prej alternativave të mëposhtme e përshkruan më mirë komunitetin në të cilin ndodhet shkolla juaj?**

*(Ju lutemi, shënoni X vetëm në një kuti.)*

| | |
|---|---|
| Fshat, lokalitet ose zonë rurale (më pak se 3 000 banorë) | ☐ 1 |
| Qytezë (me 3 000 deri 15 000 banorë) | ☐ 2 |
| Qytet (me 15 000 deri 100 000 banorë) | ☐ 3 |
| Qytet ( me mbi 100 000 banorë) | ☐ 4 |

## SC002 Që nga < 1 shkurt 2015>, cili ishte numri total i regjistrimeve në shkollë (numri i nxënësve)?

*(Ju lutemi, shkruani një numër në secilin rresht. Nëse nuk ka asnjë, shkruani 0 (zero).*

| | | |
|---|---|---|
| SC002Q01TA | Numri i djemve: | ____________ |
| SC002Q02TA | Numri i vajzave: | ____________ |

**SC003** SC003Q01TA

**Sa është numri mesatar i nxënësve për klasë në klasat e nënta dhe të dhjeta në shkollën tuaj?**

*(Ju lutemi, shënoni X vetëm në një kuti.)*

| | |
|---|---|
| 15 nxënës ose më pak | ☐ 1 |
| 16-20 nxënës | ☐ 2 |
| 21-25 nxënës | ☐ 3 |
| 26-30 nxënës | ☐ 4 |
| 31-35 nxënës | ☐ 5 |
| 36-40 nxënës | ☐ 6 |
| 41-45 nxënës | ☐ 7 |
| 46-50 nxënës | ☐ 8 |
| Më shumë se 50 nxënës | ☐ 9 |

**SC004 Objektivi i grupit të pyetjeve të mëposhtme është mbledhja e informacionit për raportin nxënës-kompjuter, për nxënësit e klasës së nënta dhe të dhjeta në shkollën tuaj.**

*(Ju lutemi, shënoni një numër në secilën hapësirë të dhënë. Shkruani 0 (zero), nëse nuk ka të tillë.)*

| | | *Numri* |
|---|---|---|
| SC004Q01TA | Sa është numri total i nxënësve të klasës së nëntë dhe të dhjetë në shkollën tuaj? | ____________ |
| SC004Q02TA | Cili është numri i përafërt i kompjuterëve të disponueshëm për nxënësit, për qëllime të arsimimit të tyre? | ____________ |
| SC004Q03TA | Cili është numri i përafërt i kompjuterëve që janë të lidhur me Internetin / Rrjetin Ndërkombëtar Informatikë? | ____________ |
| SC004Q04NA | Afërsisht, sa nga këta kompjuterë janë laptop ose tablet? | ____________ |
| SC004Q05NA | Cili është numri i përafërt i tabelave të bardha ndërvepruese të disponueshme në shkollën tuaj? | ____________ |
| SC004Q06NA | Cili është numri i përafërt i video-projektorëve të disponueshëm në shkollën tuaj? | ____________ |
| SC004Q07NA | Cili është numri i përafërt i kompjuterëve që janë të lidhur me Internetin, të disponueshëm **për mësuesit** në shkollën tuaj? | ____________ |

## SC053 Cilën nga aktivitetet e mëposhtme i ofron shkolla juaj nxënësve të klasave të nënta dhe të dhjeta këtë vit shkollor?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC053Q01TA | Grup muzikor, orkestër ose kor | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q02TA | Pjesë teatrale ose komedi muzikore | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q03TA | Almanak, gazetë ose revistë të shkollës | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q04TA | Dalja vullnetar ose aktivitete humanitare, p.sh. ndihmë për të varfrit, etj. | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q05NA | Klub i lëndëve shkencore | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q06NA | Gara në lëndët shkencore, p.sh. olimpiadat e fizikës, biologjisë dhe kimisë | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q07TA | Klub shahu | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q08TA | Klub me drejtim kryesor kompjuterët/informatikën dhe teknologjinë e komunikimit | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q09TA | Klub për artet ose aktivitetet artistike | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q10TA | Skuadër ose aktivitete sportive | ☐1 | ☐2 |
| SC053Q11TA | Tërheqje litari | ☐1 | ☐2 |

## SC059 Cila nga pohimet e mëposhtme është e vërtetë për Aktivet Profesionale të lëndëve shkencore në shkollën tuaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC059Q01NA | Krahasuar me Aktivet Profesionale e tjera, aktivi i lëndëve shkencore në shkollën tonë është i mirë përgatitur. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q02NA | Nëse ndonjëherë kemi fonde shtesë, një pjesë të konsiderueshme të tij e kalojmë për përmirësimin e mësimdhënies në lëndët shkencore në shkollë. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q03NA | Mësuesit e lëndëve shkencore në shkollë janë pjesa më e mirë arsimuar e stafit. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q04NA | Krahasuar me shkollat e tjera, ne kemi laboratorë më të mirë pajisur. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q05NA | Baza materiale për aktivitetet praktike në lëndët shkencore në shkollë është në gjendje të mirë. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q06NA | Kemi bazë materiale të mjaftueshme në laboratorë për t'i përdorur rregullisht në çdo orë. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q07NA | Ne kemi staf plus për laboratorët, që të ndihmojnë në procesin mësimor të lëndëve shkencore në shkollë. | ☐1 | ☐2 |
| SC059Q08NA | Shkolla jonë kryen shpenzime plus për pajisjen e laboratorëve të kohës së fundit. | ☐1 | ☐2 |

## SC052 A u siguron shkolla juaj nxënësve të klasave të nënta dhe të dhjeta opsionet e mëposhtme për ndihmë në mësime?

| | *(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)* | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC052Q01NA | Klasa ku nxënësit të mund të bëjnë detyrat e shtëpisë. | ☐1 | ☐2 |
| SC052Q02NA | Stafi t'i ndihmojë me detyrat e shtëpisë. | ☐1 | ☐2 |

## DREJTIMI I SHKOLLËS

**SC009 Më poshtë keni disa pohime në lidhje me drejtimin e kësaj shkolle. Ju lutemi, tregoni shpeshtësinë e kryerjes së këtyre aktiviteteve dhe mënyrave të drejtimit në shkollën tuaj gjatë vitit të fundit shkollor.**

*(Ju lutemi, zgjidhni vetëm një përgjigje për çdo rresht.)*

| | | *Kurrë* | *1-2 herë gjatë vitit* | *3-4 herë gjatë vitit* | *Një herë në muaj* | *Një herë në javë* | *Më shumë se një herë në javë* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SC009Q01TA | I përdor rezultatet shkollore të nxënësve për të zhvilluar objektivat mësimorë të shkollës. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 | ☐5 | ☐6 |
| SC009Q02TA | Kontrolloj që aktivitetet profesionale të mësuesve të jenë në përputhje me objektivat e të mësuarit të shkollës. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 | ☐5 | ☐6 |
| SC009Q03TA | Kontrolloj nëse aktivitetet në klasë janë në përputhje me objektivat pedagogjikë. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 | ☐5 | ☐6 |
| SC009Q04TA | Promovoj praktika të mësimdhënies të bazuara në kërkime arsimore të kohës së fundit. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 | ☐5 | ☐6 |
| SC009Q05TA | Përgëzoj mësuesit nxënësit e të cilëve janë pjesëmarrës aktivë në të mësuar. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 | ☐5 | ☐6 |
| SC009Q06TA | Marr iniciativën për të diskutuar çështjet sa herë që një mësues ka probleme me klasën e tij. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 | ☐5 | ☐6 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SC009Q07TA | I tërheq vëmendjen mësuesve për rëndësinë që ka zhvillimi te nxënësit i aftësive sociale dhe të të menduarit kritik. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |
| SC009Q08TA | I kushtoj vëmendje sjelljes që prish mësimin në klasa. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |
| SC009Q09TA | I siguroj stafit mundësinë e pjesëmarrjes në vendimmarrjen e shkollës. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |
| SC009Q10TA | I ftoj mësuesit të ndihmojnë ndërtimin e kulturës shkollore të përmirësimit të vazhdueshëm. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |
| SC009Q11TA | Iu kërkoj mësuesve të rishikojnë praktikat menaxhuese. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |
| SC009Q12TA | Sa herë që një mësues ngre një problem që i ka dalë në klasë, e zgjidhim atë së bashku. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |
| SC009Q13TA | I diskutoj objektivat akademikë të shkollës me mësuesit, në takime të mbajtura me mësuesit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 | ☐ 6 |

## SC010 Kush ka përgjegjësi në lidhje me kryerjen e detyrave të mëposhtme në shkollën tuaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në aq kuti sa janë të nevojshme në secilin rresht.)*

| | | Drejtorët | Mësuesit | Këshilli i Shkollës | Autoriteti Arsimor Rajonal dhe Komunal | Ministria e Arsimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SC010Q01T | Përzgjedhja për punësim e mësuesve | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q02T | Përjashtimi i mësuesve | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q03T | Përcaktimi i pagave fillestare të mësuesve | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q04T | Përcaktimi i rritjeve në pagë të mësuesve | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q05T | Hartimi i buxhetit të shkollës | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q06T | Përcaktimi i ndarjes së buxhetit brenda shkollës | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q07T | Përcaktimi i politikave disiplinore të nxënësve | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q08T | Përcaktimi i politikave për vlerësimin e nxënësve | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q09T | Miratimi i pranimit të nxënësve në shkollë | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q10T | Përzgjedhja e teksteve mësimore | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q11T | Përcaktimi i përmbajtjes së kursit | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |
| SC010Q12T | Përcaktimi i kurseve që do të ofrohen | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 | ☐ 1 |

## SC012 Sa shpesh mbahen parasysh faktorët e mëposhtëm kur pranohen nxënësit në shkollën tuaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Kurrë* | *Ndonjëherë* | *Gjithmonë* |
|---|---|---|---|---|
| SC012Q01TA | Dosja e rezultateve shkollore të nxënësit (duke përfshirë edhe testet e arritjeve) | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |
| SC012Q02TA | Rekomandimet e shkollave nga vijnë nxënësit | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |
| SC012Q03TA | Miratimi i prindit për filozofinë pedagogjike ose fetare të shkollës | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |
| SC012Q04TA | Nëse nxënësi kërkon ose është i interesuar në një program të veçantë | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |
| SC012Q05TA | Përparësia e dhënë ndaj pjesëtarëve të familjes së nxënësve të mëparshëm ose aktualë | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |
| SC012Q06TA | Vendbanimi në zona të veçanta | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |
| SC012Q07TA | Të tjera | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 |

**SC013** **A është shkolla juaj publike apo private?**

SC013Q01TA *(Ju lutemi, shënoni X vetëm në një kuti.)*

| | |
|---|---|
| Shkollë Publike<br>*(Kjo është një shkollë e drejtuar direkt ose indirekt nga një autoritet publik për arsimin, agjenci qeveritare ose bord drejtues i caktuar nga qeveria ose i zgjedhur me votim publik.)* | ☐ 1 |
| Shkollë Private<br>*(Kjo është një shkollë e drejtuar direkt ose indirekt nga një organizatë joqeveritare; p.sh. një kishë, sindikatë, biznes ose ndonjë institucion tjetër privat.)* | ☐ 2 |

**SC014** **Ç'lloj organizate drejton shkollën tuaj?**

SC014Q01NA *(Ju lutemi, shënoni X vetëm në një kuti.)*

| | |
|---|---|
| Një kishë ose organizatë tjetër fetare. | ☐ 1 |
| Një organizatë tjetër jo- fitimprurëse. | ☐ 2 |
| Një organizatë fitimprurëse. | ☐ 3 |

**SC016 Sa përqind e financimit tuaj të përgjithshëm, për një vit shkollor të zakonshëm, vjen nga burimet e mëposhtme?**

*(Ju lutemi shkruani një numër në secilin rresht. Nëse një nga burimet nuk kontribuon në buxhetin tuaj, shkruani 0 (zero)në vijën korresponduese.)*

| | | % |
|---|---|---|
| SC016Q01TA | Qeveria (përfshin ministritë, pushtetin lokal, rajonal, shtetëror dhe kombëtar) | ____________ |
| SC016Q02TA | Tarifat e nxënësve dhe shpenzimet shkollore të paguara nga prindërit | ____________ |
| SC016Q03TA | Dhurimet, trashëgimitë, sponzorizimet, mbledhjen e fondeve nga prindërit | ____________ |
| SC016Q04TA | Burime të tjera. | ____________ |
| | *Totali* | *100%* |

## SC017 A pengohet nga çështjet e mëposhtme mësimdhënia në shkollën tuaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Aspak* | *Shumë pak* | *Deri në njëfarë mase* | *Shumë* |
|---|---|---|---|---|---|
| SC017Q01NA | Mungesa e stafit mësimor | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q02NA | Staf joadekuat mësuesish ose pak të kualifikuar. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q03NA | Mungesa e stafit ndihmës. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q04NA | Staf joadekuat ndihmës ose pak të kualifikuar. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q05NA | Mungesë e materialeve mësimore (p.sh, tekste shkollore, pajisje të IT, bibliotekë ose laboratorë). | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q06NA | Materiale mësimore jo adekuate ose pa cilësi (p.sh, tekste shkollore, pajisje të IT, bibliotekë ose laboratorë). | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q07NA | Mungesë e infrastrukturës fizike (p.sh, ndërtesa, sheshe, ngrohje/ftohje, ndriçim dhe sistem akustik). | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |
| SC017Q08NA | Infrastrukturë fizike (p.sh, ndërtesa, sheshe, sisteme ngrohje/ftohje, ndriçimi dhe akustike) joadekuate dhe me cilësi të dobët. | ☐1 | ☐2 | ☐3 | ☐4 |

## STAFI PEDAGOGJIK

## SC018 Sa nga mësuesit e mëposhtëm janë në stafin pedagogjik të shkollës suaj?

***Përfshini edhe mësuesit me kohë të pjesshme edhe ata me kohë të plotë.*** *Një mësues me kohë të plotë punësohet për 90% të kohës si një mësues për një vit të plotë shkollor. Të gjithë mësuesit e tjerë duhet të quhen me kohë të pjesshme. Duke u mbështetur në nivelin e kualifikimit, ju lutemi referojuni* ***nivelit më të lartë të kualifikimit*** *të mësuesve.*

*(Ju lutemi, shkruani një numër në secilën hapësirë të dhënë. Shkruani 0 (zero) nëse nuk ka asnjë.)*

| | | *Me kohë të plotë* | *Me kohë të pjesshme* |
|---|---|---|---|
| SC018Q01TA | Mësues GJITHSEJ | ____________ | ____________ |
| SC018Q02TA | Mësues të certifikuar nga Ministria e Arsimit | ____________ | ____________ |
| SC018Q05NA | Mësues me kualifikim Diploma Bachelor | ____________ | ____________ |
| SC018Q06NA | Mësues me kualifikim Diploma Master | ____________ | ____________ |
| SC018Q07NA | Mësues me kualifikim Doktoratë | ____________ | ____________ |

## SC019 Sa nga kategoritë e mësuesve të shkencave natyrore, që jepen më poshtë, ka në shkollën tuaj?

***Përfshini edhe mësuesit me kohë të pjesshme edhe ata me kohë të plotë.*** *Një mësues me kohë të plotë punësohet për 90% të kohës si një mësues për një vit të plotë shkollor. Të gjithë mësuesit e tjerë duhet të quhen me kohë të pjesshme.*

*(Ju lutemi, shkruani një numër në secilën hapësirë të dhënë. Shkruani 0 (zero) nëse nuk ka asnjë.)*

| | | *Me kohë të plotë* | *Me kohë të pjesshme* |
|---|---|---|---|
| SC019Q01NA | Mësues të shkencave GJITHËSEJ | ____________ | ____________ |
| SC019Q02NA | Mësues të shkencave, të njohur plotësisht nga Drejtoria Komunale Arsimore | ____________ | ____________ |
| SC019Q03NA | Mësues të shkencave me kualifikim Diploma Bachelor, ose më të lartë me diplomë në shkenca | ____________ | ____________ |

**SC025 Gjatë tre muajve të fundit, sa përqind e stafit të mësuesve të shkollës suaj ka ndjekur një program për zhvillimin profesional?**

*Programi i zhvillimit profesional është një program i ndërtuar për të rritur aftësitë mësimdhënëse ose praktikat pedagogjike. Ai mund ose jo t'i parapr ijë një kualifikimi të njohur. Programi duhet të zgjasë të paktën një ditë në total dhe të përqendrohet në edukimin dhe mësimdhënien.*

*(Ju lutemi, shkruani përqindjen e duhur në çdo rresht. Nëse në këto aktivitete të zhvillimit profesional nuk ka marrë pjesë asnjë mësues, shkruani"0" (zero).*

| | | |
|---|---|---|
| SC025Q01NA | I gjithë stafi i shkollës tuaj | __________ |
| SC025Q02NA | Mësuesit e shkencave në shkollën tuaj | __________ |

## SC027 Cilat nga këto tipa të zhvillimit të brendshëm profesional (brenda shkollës) ekzistojnë në shkollën tuaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC027Q01NA | Në shkollën tonë mësuesit shkëmbejnë ide ose materiale për tema mësimore ose kapituj specifikë. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC027Q02NA | Shkolla jonë fton specialistë për trajnim e mësuesve të shkollës. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC027Q03NA | Shkolla jonë organizon seminare për mësuesit e shkollës për të trajtuar çështje specifike me të cilat përballet shkolla. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC027Q04NA | Shkolla jonë organizon seminare brenda shkollës, për grupe specifike mësuesish të shkollës (p.sh, mësues të sapoemëruar). | ☐ 1 | ☐ 2 |

## TESTIMI DHE VLERËSIMI

## SC032 Gjatë vitit të fundit shkollor, a është përdorur ndonjë nga metodat e mëposhtme për të monitoruar praktikën e mësuesve të shkollës suaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC032Q01TA | Testimet ose vlerësimet e arritjeve të nxënësve. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC032Q02TA | Vlerësimet ndërmjet mësuesve (planet mësimore, mjetet e vlerësimit dhe mësimet). | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC032Q03TA | Vëzhgimi i mësimit nga drejtoria ose mësuesit e vjetër. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC032Q04TA | Vëzhgimi i mësimit nga inspektorët ose persona të tjerë nga jashtë shkollës. | ☐ 1 | ☐ 2 |

## SC034 Në përgjithësi në shkollën tuaj, sa shpesh vlerësohen nxënësit e klasës së nëntë dhe të dhjetë sipas metodave të mëposhtme?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Kurrë* | *1-2 herë në vit* | *3-5 herë në vit* | *Çdo muaj* | *Më shumë se një herë në muaj* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SC034Q01NA | Teste të standardizuara të detyruara, p.sh, testet e arritshmërisë | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 |
| SC034Q02NA | Teste të standardizuara jo të detyruara, (p.sh, (teste të standardizuara, të vlefshme për të interesuarit si testet semestrale). | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 |
| SC034Q03TA | Teste të hartuar nga mësuesit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 |
| SC034Q04TA | Vlerësime jo formale nga mësuesit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 | ☐ 5 |

*Ju lutemi përgjigjuni kësaj pyetje vetëm nëse në shkollën tuaj përdorni testet e standardizuara dhe/ose testet e hartuara nga mësuesit.*

**SC035** **A përdoren me klasat e nënta dhe të dhjeta të shkollës suaj testet e standardizuara ose ato të hartuara nga mësuesit për ndonjë nga arsyet e mëposhtme?**

*(Ju lutemi, zgjidhni "po" ose "jo" për të treguar përdorimin e testeve të standardizuara ose ato të hartuara nga mësuesit për secilën nga qëllimet e shprehura më poshtë.)*

| | | *Teste të standardizuara* | | *Teste të hartuara nga mësuesit* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | *Po* | *Jo* | *Po* | *Jo* |
| SC035Q01N | Për të udhëhequr të mësuarit tek nxënësit | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q02T | Për të informuar prindërit për përparimin e fëmijëve të tyre | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q03T | Për të marrë vendime për përsëritjen ose kalimin e klasës nga nxënësit | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q04T | Për të grupuar nxënësit për qëllime mësimore | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q05T | Për të krahasuar ecurinë e shkollës në nivel rajonal ose kombëtar | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q06T | Për të monitoruar progresin e shkollës nga një vit në tjetrin | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q07T | Për të gjykuar për efektshmërinë e mësuesve | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q08T | Për të identifikuar aspekte të mësimdhënies ose të kurrikulës që mund të përmirësohen | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q09N | Për të përshtatur mësimdhënien me nevojat e nxënësve | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q10T | Për të krahasuar shkollën me shkolla të tjera | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |
| SC035Q11N | Për tu dhënë nxënësve certifikata | ☐1 | ☐2 | ☐1 | ☐2 |

## SC036 Në shkollën tuaj, a përdoren të dhënat që lidhen me rezultatet shkollore të nxënësve në ndonjë nga procedurat e llogaridhënies?

*Me të dhëna për rezultatet shkollore nënkuptohen notat ose rezultatet e përgjithshme të provimeve në shkollë ose përqindja e diplomimeve* ***në total****.*

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC036Q01TA | Të dhënat që lidhen me rezultatet shkollore bëhen publike (p.sh. në media). | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC036Q02TA | Të dhënat që lidhen me rezultatet shkollore ndiqen herë pas here nga një autoritet administrativ. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC036Q03NA | Të dhënat që lidhen me rezultatet shkollore u jepen direkt prindërve. | ☐ 1 | ☐ 2 |

## SC037 A ekzistojnë në shkollën tuaj masat e mëposhtme në lidhje me sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në ç’formë shprehen ato?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po, kjo është e detyrueshme bazuar në politikat e Ministrisë dhe DKA-s* | *Po, bazuar në iniciativat e shkollës* | *Jo* |
|---|---|---|---|---|
| SC037Q01TA | Vlerësim i brendshëm/ vetëvlerësim. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q02TA | Vlerësim i jashtëm. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q03TA | Shkrim i detajuar i profilit kurrikular dhe objektivave mësimorë të shkollës. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q04TA | Shkrim i detajuar i standardeve të arritjes së nxënësit. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q05NA | Regjistrim i rregullt i të dhënave, që lidhen me pjesëmarrjen e mësuesve dhe nxënësve dhe zhvillimin profesional. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q06NA | Regjistrim i rregullt i të dhënave që lidhen me rezultatet e testeve të nxënësve dhe përqindjen e kalueshmërisë së tyre. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q07TA | Opinion i kërkuar me shkrim nxënësve (p.sh, lidhur me mësimet, mësuesit, bazën materiale mësimore) | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q08TA | Këshillimi i mësuesit | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q09TA | Konsultime të rregullta me një ose më shumë ekspertë, me qëllim përmirësimin e shkollës për një periudhë të paktën 6 mujore. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC037Q10NA | Zbatimi i politikave të standardizuara në lëndët e shkencave në shkollë (p.sh,kurrikula shkollore me materiale udhëzuese që shoqërojnë trajnimin dhe zhvillimin e stafit). | ☐1 | ☐2 | ☐3 |

*Ju lutemi përgjigjuni kësaj pyetjeje vetëm nëse në shkollëntuaj është bërë së paku një vlerësim i brendshëm.*

## SC040 A ka marrë shkolla juaj ndonjë masë për çështjet e mëposhtme, bazuar në rezultatet e fundit të vlerësimit të brendshëm?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo, sepse rezultatet ishin të kënaqshme* | *Jo, për arsye të tjera* |
|---|---|---|---|---|
| SC040Q02NA | Stafin pedagogjik (p.sh. norma mësimore, kërkesa personale, kualifikime). | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q03NA | Zbatimin e kurrikulës. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q05NA | Cilësia e të mësuarit dhe mësimdhënies. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q11NA | Angazhimin e prindërve në shkollë. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q12NA | Zhvillimin profesional të mësuesve. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q15NA | Arritjet e nxënësve. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q16NA | Kompetencat ndërlëndore të nxënësve. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC040Q17NA | Barazinë në shkollë. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |

*Ju lutemi përgjigjuni kësaj pyetjeje vetëm nëse në shkollën tuaj është bërë së paku një vlerësim i jashtëm.*

## SC041 Sillni ndërmend vlerësimin e fundit të jashtëm në shkollën tuaj: a gjejnë zbatim pohimet e mëposhtme?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC041Q01NA | Rezultatet e vlerësimeve të jashtme u bënë shkak për ndryshim të politikave të shkollës. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC041Q03NA | Ne përdorëm të dhënat, për të planifikuar veprimtari specifike për zhvillimin e shkollës. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC041Q04NA | Ne përdorëm të dhënat, për të planifikuar veprimtari specifike për përmirësimin e mësimdhënies. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC041Q05NA | Ne vendosëm, masa bazuar në rezultatet e vlerësimeve të jashtme. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC041Q06NA | Stimuli i shkaktuar nga vlerësimi i jashtëm, u “zhduk” shumë shpejt në shkollën tonë. | ☐ 1 | ☐ 2 |

## GRUPET NË FOKUS TË STUDIMIT

**SC042** *Disa shkolla i organizojnë orët mësimore të ndryshme për nxënësit me aftësi të ndryshme.*

**Në lidhje me këtë çështje, cila është politika e shkollës suaj për nxënësit e klasave të nënta dhe të dhjeta?**

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Për të gjitha lëndët* | *Për disa nga lëndët* | *Për asnjë nga lëndët* |
|---|---|---|---|---|
| SC042Q01TA | Nxënësit grupohen në klasa të ndryshme, sipas aftësive. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |
| SC042Q02TA | Nxënësit grupohen brenda klasave të tyre, sipas aftësive. | ☐1 | ☐2 | ☐3 |

**SC048 Ju lutemi vlerësoni përqindjen e nxënësve të klasave të nënta dhe të dhjeta në shkollën tuaj që kanë karakteristikat e mëposhtme.**

*(Ju lutemi, mbani parasysh se nxënësit mund t'i përkasin kategorive të ndryshme.)*

*(Ju lutemi, shkruani përqindjen e duhur në çdo rresht.)*

| | | |
|---|---|---|
| SC048Q01NA | Nxënës, gjuha e origjinës së të cilëve, është e ndryshme nga shqipja. | ________ |
| SC048Q02NA | Nxënës me nevoja të veçanta. | ________ |
| SC048Q03NA | Nxënës që vijnë nga familje me nivel jo të lartë shoqëror dhe ekonomik. | ________ |

## ATMOSFERA NË SHKOLLË

## SC061 Në shkollën tuaj, deri në çfarë mase pengohet mësimi i nxënësve nga dukuritë e mëposhtme?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Aspak* | *Shumë pak* | *Deri në njëfarë mase* | *Shumë* |
|---|---|---|---|---|---|
| SC061Q01TA | Mungesat e pajustifikuara të nxënësve. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q02TA | Nxënësit lënë orët e mësimit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q03TA | Mungesa e respektit të nxënësve për mësuesit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q04TA | Përdorimi i alkoolit ose drogave të paligjshme nga nxënësit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q05TA | Nxënës që frikësojnë ose keqtrajtojnë nxënës të tjerë. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q06TA | Mësuesit nuk plotësojnë nevojat individuale të nxënësve. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q07TA | Mungesat e mësuesve. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q08TA | Rezistenca e stafit ndaj ndryshimit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q09TA | Të qenët e mësuesve shumë strikt me nxënësit. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |
| SC061Q10TA | Mësuesit nuk janë të përgatitur mirë për mësimin. | ☐ 1 | ☐ 2 | ☐ 3 | ☐ 4 |

## SC063 A gjejnë zbatim pohimet e mëposhtme lidhur me përfshirjen e prindërve në shkollën tuaj?

*(Ju lutemi, shënoni X në një kuti në secilin rresht.)*

| | | *Po* | *Jo* |
|---|---|---|---|
| SC063Q02NA | Shkolla jonë i mirëpret dhe i fton prindërit që të përfshihen në shkollë | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC063Q03NA | Shkolla jonë projekton komunikime të formave shkollë-shtëpi dhe shtëpi-shkollë rreth programeve të shkollës mbi dhe ecurisë së fëmijëve në shkollë. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC063Q04NA | Shkolla jonë përfshin prindërit në vendim-marrje. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC063Q06NA | Shkolla jonë u ofron familjeve informacione dhe ide si të ndihmojnë nxënësit në shtëpi me detyrat, vendimet, planifikimet dhe aktivitete të tjera të lidhura me kurrikulën. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC063Q07NA | Shkolla jonë identifikon dhe integron burimet dhe shërbimet e komunitetit, për të forcuar programin e shkollës, praktikat në familje si dhe zhvillimin e të mësuarit e nxënësve. | ☐ 1 | ☐ 2 |
| SC063Q09NA | Ekziston një legjislacion shtetëror për përfshirjen e prindërve në aktivitetet e shkollës. | ☐ 1 | ☐ 2 |

**SC064 Gjatë vitit të kaluar shkollor sa përqind e prindërve të nxënësve kanë marrë pjesë në aktivitetet e mëposhtme lidhur me shkollën?**

*(Ju lutemi, shënoni një numër në secilin rresht. Shënoni 0 (zero), nëse në aktivitet nuk ka marrë pjesë asnjë prind. Shkruani 100 (njëqind,) nëse të gjithë prindërit kanë marrë pjesë në aktivitet.)*

| | | % |
|---|---|---|
| SC064Q01TA | Për të diskutuar progresin e fëmijës së tyre me një mësues me iniciativën e tyre, | ________ |
| SC064Q02TA | Për të diskutuar progresin e fëmijës së tyre me iniciativën e njërit prej mësuesve të fëmijës së tyre, | ________ |
| SC064Q03TA | Për të marrë pjesë në qeverinë e shkollës lokale, p.sh komiteti i prindërve apo bordi i menaxhimit të shkollës, | ________ |
| SC064Q04NA | Për të marrë pjesë vullnetarisht në aktivitete fizike ose aktivitete jashtëshkollore (p.sh mirëmbajtje ndërtesash, punë zdrukthëtari, kopshtari, punë në oborrin e shkollës, teatri i shkollës, sporte, ekskursione), | ________ |

***Faleminderit shumë për bashkëpunimin tuaj në plotësimin e këtij pyetësori!***